



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**DURRES**

<b>Numri i Çështjes</b>	61012-01076-11-2016	<b>Data e Regjistrimit</b>	6/14/2016
<b>Numri i Vendimit</b>	11-2016-4050	<b>Data e Vendimit</b>	9/27/2016

**VENDIM**  
**NE EMER TE REPUBLIKËS**

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRES E PERBERE NGA:**

**KRYESUES:** Shpëtime Pitaku

**ANËTAR**

**SEKRETARE** Alma Doraku

**Objekti:** Kërkoj heqjen e masës së sekuestros preventive mbi të gjitha llogaritë bankare vënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr.342 date 25. 05.2016, në bankat Intesa San Paolo ,Banka Raiffeisen, Banka Kombetare Tregtare, Banka Nderkombetare Tregtare Banka Procredit, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Banka Tirana,Banka Kombetare e Greqisë, Banka Credit Agricole, Banka e pare e Investimeve në Shqipëri,Banka Credins, Banka e Kredit ne Shqipëri, Banka Societe Generale Albania, Banka Veneto, Banka Alpha, Banka Unionon, kërkesë kjo që gjën mbështetje në nenin 274/3 të K.Pr.Penale.

**Baza Ligjore :** Neni 274/3 i K.Pr.Penale.

**Përmbledhja e vendimit:**

Gjykata konstaton kryesisht se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor sipas përcaktimeve të nenit 69 e vijues të K.Pr.Penale dhe se në bazë të neneve 74,76 e vijues të K.Pr.Penale, ajo është kompetente për shqyrtimin e kërkesës.

Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës në prani të palëve të cilët kërkuan:

Përfaqësuesi I kërkuarit:Pranimin e kërkesës.

Prokurori-Rrëzimin e kërkesës.

Gjykata pasi dëgjoji palët,dhe shqyrtoi kerkesën,provat dhe bazën ligjore të kësaj kërkesë

Vëren:

\*\*\*\*\* pranë \*\*\*\*\* se Shkallës se Parë Durrës ka rregjistruar proçedimin penal nr.765 date 05/05/2016 per kryerjen e figures se vepres penale te "Pastrimit te produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale" parashikuar nga neni 287 i K.Penal, mbi bazen e materialeve te referuara nga Drejtoria e Policise se Qarkut Durres.

Mbi kërkesën e organit të Prokurorisë Durrës,Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr.342 datë 25.05.2016,ka vendosur: Pranimin e kërkesës se Prokurorisë pranë \*\*\*\*\* së Shkalles së Pare Durrës.

Vendosjen e mases se sigurimit pasuror, sekuestro preventive mbi sendin” Të gjitha llojet e depozitave dhe të llogarive bankare në bankat Banka Intesa San Paolo, Banka Raiffeisen, Banka Kombetare Tregtare, Banka Nderkombetare Tregtare, Banka Procredit, Banka e



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**DURRES**

Bashkuar e Shqipërisë, Banka Tirana, Banka Kombetare e Greqise, Banka Credit Agricole, Banka e Pare e Investimeve ne Shqiperi, Bankes Kredins, Bankes se Kreditit te Shqiperise, Bankes Societe Generale Albania, Banka Veneto, Banka Aalpha Albania, Bankes Union në emër të;

1.Shtetasit Çesare \*\*\*\*\* i datelindjes 27.05.1964

2.Shoqëri \*\*\*\*\* Corp Enterprise" me NIPT L3 1904508T

\*\*\*\*\* Corp Enterprise" me kërkesë datë 13.06.2016 të depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës ka kërkuar heqjen e sekuestros së vendosur me vendimin e sipërcituar duke pretenduar se:

**Së pari:** Vendosja e sekuestros preventive konform nenit 274 të K.pr.penale, është e lidhur në mënyrë të pazgjydhshme, me veprën penale që në rastin konkret nuk egziston.

**Së dyti:** Shoqëria \*\*\*\*\* Corp Enterprise" që nga moment i krijimit e aktualisht është aktive.

**Së treti:** Transfera e parave në shumën 607.000 euro, nga bashkëshortja e kërkuarit, rrjedh nga të ardhurat e një regjimi pasuror, të ndarë midis bashkëshortëve.

Nga ana e saj përfaqësuesja e Prokurorisë Durrës ka pretenduar se "Lidhur me kërkesën e paraqitur për heqjen e sekuestros preventive për vendimin e marrë nga kjo gjykatë i bëjmë me dije gjykatës se dhe aktet janë në dosje dhe ky person akuzohet për "Pastrim të produkteve të veprës penale apo veprimtariisë kriminale" dhe procedimi penal është nisur mbi bazën e informacionit të dokumentuar për aktivitetin kriminal të kryer nga shtetasi Çezar Bonavia në shtetin e Italisë. Një informacioni i sjellë nga zyra e ndërlidhjes së Interforcës, shtetasi Çezar Bonavia është hetur ne shtetin italian për mashtrim, per perpilim të faturave fiktive, dhe këto të dhëna kanë iniciuar për fillimin e procesit penal. Gjate hetimit te deri tanishëm është dërguar leterporosia autoriteve italiane , janë marrë të dhëna ne kuadër e veprime hetimore te tyre, si kqyrja e sistemit TIMS te shtetasit Çesare Bonadia dhe Xhovani Batalia, janë marre të dhëna edhe nga Dega e Tatimeve ne lidhj me aktivitet kompanisë " Naes \*\*\*\*\* Corp Enterprise", janë pyetur persona me cilësinë e personave që kanë dijeni për çështjen penale. Nga verifikimet e bëra në selinë ku figuron e regjistruar kjo shoqëri pranë QKR ku ushtron aktivitetin, kjo kompani rezulton se ka gjithsej te rregjistruar vetëm dy persona dhe nga ana e kërkuarit pretendohet se ka nje aktivitet tregtar të vazhdueshëm në seline e rregjistruar pranë QKR. Nga kryerja ne vend në selinë ku ushtron aktivitetin kjo shoqëri nuk ka qënë prezent asnjë person, përfaqësuesi i kësaj kompania apo i punësuar i kësaj kompanie".

Nga shqyrtimi i provave dhe pretendimeve të palëve në seancë gjyqësore rezultoi e provuar se:

"Shoqëria Naes \*\*\*\*\* Corp Enterprise", është regjistruar pranë QKR më dt 04.07.2013 me NIPT L 3190 450811".

Objekt i aktivitetit të saj është "Import-eksport", përfaqësimi me dhe pa depozitë konsulence për shitjen dhe blerjen e mallrave, mobilje me shumice dhe pakice, shtëpi, mobilje të të gjithë llojeve, etj.

Kjo shoqëri qe nga momenti i krijimit dhe aktualisht provohet se ka aktivitet si në blerje ashtu dhe në shitje sipas ketij objekti të percaktuar në çertifikaten e regjistrimit.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**DURRES**

Fakti që kjo shoqëri është aktive provohet me bilancet financiare dhe deklarin në Zyren e Tatimeve në vite.

Gjatë aktivitetit të saj që nga moment i krijimit në vitin 2011,rezulton se Shoq \*\*\*\*\* Corp Enterprise"ka qënë objekt i kontrolleve nga Tatim Taksat.

Fillimisht rrezulton se është kontrolluar në dt 26.10.2015 dhe per rezultatet e këtij kontrolli është mbajtur Akt- Konstatimi nr. 0635567 dt. 26.10.2015, në të cilin është pershkruar gjendja e gjetur e subjektit.

Se fundi Drejtoria Rajonale Tatimore ka ushtruar një kontroll pranë kesaj shoqerie dhe në dt. 30.05.2016 ka mbajtur një Akt- Konstatimi në të cilin ka evidentuar faktin se

- 1)Tatim paguesi është i regjistruar në organin tatimor dhe QKR..
- 2.Subjekti I kryen transaksionet monetare vetëm nëpermjet bankave.
- 3.Ne pune u gjent Çesare Bonadia(AA 05 75 268).
- 4.Ushtron Aktivitet në ambient me qera dhe është i regjistruar per tatim me burim.
- 5.Statusi I subjektit është aktiv".

Akt kontrollet e sipërcituara janë administruar nga Gjykata si prove dhe ndodhen në dosjen gjyqsore.

Veç kësaj ka rezultuar se , Drejtoria Rajonale e Tatimeve, në vitin 2014 ka ushtruar një kontroll të përgjithshem mbi bazen e kerkeses së vet subjektit per rimbursimin e TVSH-se.

Me shkresen nr. 102/13 dt. 21.11.2014 shoqerise \*\*\*\*\* Corp Enterprise" i është percjelle raporti i kontrollit,nga i cili ka rezultuar se "I njihet e rimbursueshme teprica kreditore e Tvsh-se prej 1. 963.556 lekë, kjo tepricë kreditore është krijuar nga ana e subjektit në periudhën 0712013-1212013 ne vleren 1.500.555 leke, dhe vlerën prej 525.320 lekë në vitin 2014, nga teprica kreditore e vitit 2014 subjektit i zbritet Tvsh-ja e krjuar nga referencat doganore për periudhen e kontrolluar në vleren 62.319 lekë, pra për vitin 2014 Tvsh e krijuar nga shuma e kërkuar per rimbursim është 463.001 lekë,e në fund të periudhes se kontrolluar 09/2014 subjekti ka një teprice kreditore 4.492. 099 lekë".

Aktiviteti i shoqerise në vite dëshmohet dhe me bilancet (pasqyrat financiare të viteve 2013,2014,2015) të administruara nga Gjykata në Gjykimin e çështjes.

Fakti qe kjo shoqëri ka qene aktive vertetohet dhe me shume trasferta bankare që ka bërë,e gjithashtu të administruara si prova ne gjykim.

Përsa i përket transfertës së parave në shumën 607.000 € nga bashkëshortja e kërkuarit rezulton se ajo rrjedh nga të ardhurat e një regjimi pasuror të ndarë midis bashkëshortëve.

Sipas ekstraktit përmbledhës te aktit te martesës me nr.7283,administruar në gjykim, rezulton se bashkeshortet Çesare \*\*\*\*\* dhe Tera Marinaçi kane nenshkruar marveshjen martesore të përbërë nga regjime pasurore të ndara në dt. 22.11.2011.

Per rrjedhoje ata kane aktivite dhe te ardhura te pavarura nga njeri tjetri. Ajo është aksionere e vetme e shoqerise B&C General Trading SRL Milano.

Në deklarimet që ka bërë bashkëshortja e kërkuarit për të ardhurat e vitit 2014 rezulton që



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**DURRES**

nga aktiviteti i saj ajo të ketë fituar 214.991 €.

Më dt 18.9.2015, është lidhur ndërmjet kërkuarit dhe bashkeshortës së tij znj. Marinacci një kontratë paraprake e shitjes së kuaotave të shoqërisë \*\*\*\*\* Corp Enterprise" shpk ,ku z. \*\*\*\*\* premtori të kalojë znj. Marinacci 80% të aksioneve të kapitalit duke vënë kushtin e nënshkrimit personal të paleve duhet të bëhet brenda dt. 31.12.2016.

Nga shqyrtimi i provave në gjykim Gjykata çmon se kërkesa e kërkuarit është e drejtë e bazuar në ligj e si e tillë duhet pranuar.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr.342 datë 25.05.2016, ka vendosur sekuestro preventive mbi bazën e informacionit se shtetasi Italian Çezare \*\*\*\*\* merrej me aktivitet kriminal në shtetin Italian, e në Shqipëri merrej me pastrimin e produkteve të veprave penale të kryera atje.

Pas katër muaj hetim Organi I Prokurorisë nuk mundi të provojë faktin që shtetasi Italian Çezare \*\*\*\*\* ,është dënues në shtetin Italian për ndonjë vepër penale, apo veprimtari kriminale.

Neni 287 i K.pr.Penale kërkon patjetër që të jetë provuar kryerja e veprës penale, apo aktiviteti kriminal, paratë e së cilës po pastrohen, e cila mund të provohet vetëm me një vendim gjyqësor të formës së prerë.

Përfaqësuesi i kërkuarit paraqiti në gjykim dëshmin e penales për shtetasin Çezare \*\*\*\*\* lëshuar nga autoritetet italiane ,nga ku ai nuk rezultoi i dënues për ndonjë vepër penale, apo të jetë në ndjekje penale, në shtetin Italian.

Në këto kushte, nga sa u arsyetua më sipër, e në mbështetje të nenit 274/3 të K.Pr.Penale, gjykata çmon se kanë ndryshuar kushtet e zbatimit të masës së sekuestros preventive të vendosur me vendimin nr.342 datë 25.05.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

**Për keto arsye:**

Baza Ligjore:

Gjykata mbështetur në nenin 274/3 të K.Pr.Penale



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**DURRES**

Vendosi:

Pranimin e kërkesën së kërkuases shoqërisë “Naes \*\*\*\*\* Corp Enterpris”.

-Heqjen e sekuestros preventive mbi sendin, të vendosur me vendim nr.342 datë 25.05.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në të gjitha llojet e depozitave dhe të llogarive bankare në bankat: Banka Intesa San Paolo, Banka Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Ndërkombëtare Tregtare, Banka Procredit, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Banka Tirana, Banka Kombëtare e Greqisë, Banka Credit Agricole, Banka e Parë e Investimeve në Shqipëri, Banka Credins, Bankës së Kreditit të Shqipërisë, Bankës Societe Generale Albania, Banka Veneto, Banka Alpha Albania, Bankës Union në emër të;

1- Shtetasit - \*\*\*\*\* , i datëlindjes 27.05.1964.

2- Shoqërisë “Naes \*\*\*\*\* Corp Enterpris” me nr Nipti L31904508T.

-Urdhërohet \*\*\*\*\* e Rrethit Gjyqësor Durrës të ekzekutojë këtë vendim.

-Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të kërkuarit.

-Kundër vendimit lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Durrës brenda 10 ditëve nga e nesërmja e shpallje se tij.

-U shpall sot me datë 19.09.2016.

Ky dokument është marrë nga [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al). Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.